



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 208, Datë 08.10.2021

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MBI MASAT E TË
LICENCUARVE NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT ME ENERGJI PËR ARRITJEN E
TREGUESVE TË MATJES DHE VLERËSIMIT NGA ERE TË PERFORMANCËS SË
SHËRBIMIT NDAJ KLIENTIT**

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, 16 dhe 20, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 6, pika 3, 16, pika 18, të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar; nenit 15 dhe 26, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, pasi shqyrtoi relacionin nr. 129/2 prot., datë 06.10.2021 të Drejtorise së Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”,

Konstatoi se:

- Në pikën 4.2, të Objektivave Strategjike të ERE për periudhën 2021-2023, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.74/2021 është parashikuar se: “ERE do të përgatisë treguesit e matjes dhe vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj Klientit që garanton çdo i licencuar në furnizim”.
- Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2020, ku mes të tjerave ka përcaktuar detyrat e ERE për zbatim gjatë vitit 2021.
- Në pikën 5, të Rezolutës është parashikuar se: ERE duhet të punojë për hartimin e treguesit të matjes dhe vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj klientit që garanton çdo i

licencuar për furnizim, për të bërë të mundur ofrimin e një shërbimi cilësor dhe me standarde për konsumatorin.

- Në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” të ndryshuar, ERE ka të drejtën dhe detyrën për të monitoruar, kontrolluar dhe inspektuar shërbimet e operatoreve të licencuar në lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore, si dhe zbatimin e vendimeve dhe urdhrave të ERE-s.
- Kjo rregullore synon të adresojë masat që të licencuarit në aktivitetin e furnizimit duhet të marrin me qëllim garantimin e një shërbimi konsumator cilësor, por edhe hapat që duhet të ndjekin me qëllim garantimin e sa më sipër nëpërmjet informimit, sigurimit të mjeteve të brendshme menaxheriale me qëllim adresimin e ankesave, investimeve në burime njerëzore kompetente dhe të mjaftueshme apo garantimit të aksesit të ERE në mbikëqyrjen e përmbushjes së këtyre treguesve sipas periodave të parashikuara në këtë Rregullore.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit.
2. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare për të licencuarit në sektorin e gazit natyror.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI